

**RELACION SHPJEGUES
PËR
PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 575,
DATË 24.6.2015 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN
E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektakti është adresimi i problematikave të grumbulluara ndër vite lidhur me menaxhimin e mbetjeve inerte nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për përballimin e situatës aktuale në kushtet e ezaurimit të kapaciteteve ekzistuese të lëndfilleve të mbetjeve inerte si dhe përcaktimi dhe përmirësimi i procedurave të menaxhimit të këtyre mbetjeve, nëpërmjet venddepozitimeve të përkohshme.

Ndryshimet e propozuara nëpërmjet këtij projektvendimi kanë si objektiv dhe synojnë të inkurajojnë ripërdorimin e mbetjeve inerte të krijuara nga projektet e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo nga shembja, në përputhje me politikat dhe EU ‘Acquis’.

Një tjetër objektiv është rritja e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e mbetjeve inerte duke parashikuar ripërdorimin e tyre si edhe dokumentacionin përkatës në rastet e ripërdorimit, depozitimit të përkohshëm apo transferimit të tyre, për të garantuar kontrollin efektiv dhe parandalimin e depozitimit informal ose të paligjshëm.

Në kuadër të menaxhimit të decentralizuar dhe qëndrueshëm të territorit, në kushtet kur lëndfillet ekzistuese të mbetjeve inerte kanë arritur kapacitetin e tyre maksimal, deri në ndërtimin e lëndfilleve të reja, nëpërmjet këtyre ndryshimeve dhe shtesave, synohet përfshirja dhe nxitja e qeverisjes vendore dhe Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve në identifikimin dhe administrimin e venddepozitimeve të përkohshme për këto lloje mbetjesh.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të projektakteve për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mbetjet inerte, siç përkufizohen në ligjin nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, janë mbetjet të cilat nuk transformohen kimikisht, fizikisht, apo biologjikisht dhe nuk ndërveprojnë kimikisht me lëndë të tjera¹. Këtu përfshihen ndër të tjera edhe dherat e gërmimeve të ndërtimit si dhe materialet nga ndërtimi dhe shembja. Duke përjashtuar rastin kur këto materiale mund të ripërdoren për ndërtim, destinacioni final i tyre është depozitimi në lëndfille të dedikuara për këto lloje mbetjesh.

Në kushtet kur lëndfillet ekzistuese të mbetjeve inerte kanë arritur kapacitetin e tyre maksimal, deri në ndërtimin e lëndfilleve të reja, bashkitë përkatëse duhet të identifikojnë pasuritë që do të shërbejnë si venddepozitime të përkohshme.

Legjislacioni në fuqi ngarkon NJVV-të që të parashikojnë zonat që do të shërbejnë si venddepozitime të përkohshme të këtyre llojeve të mbetjeve. Këto zona i paraprijnë ndërtimit të lëndfilleve dhe shfrytëzohen për të njëjtin qëllim deri në ndërtimin e tyre.

AKEM-i, në kuptim të këtij vendimi, ushtron mbikqyrjen dhe ndjekjen e funksionimit të venddepozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte. Duke vlerësuar se mirëmenaxhimi i inerteve, në thelb, sjell një të mirë publike, nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, synohet që roli i operatorit, krahas

¹ “Mbetje inerte” janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.

subjekteve private, në kuptim të këtij vendimi, të ushtrohet edhe nga Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (këtu e në vijim AKEM).

Efektet e projektaktit pritet të kenë një ndikim pozitiv në përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve inerte, nëpërmjet promovimit të ripërdorimit të tyre, duke kontribuar në ciklin e mbyllur të përdorimit të materialeve ndërtimore si dhe të inkurajojnë parandalimin e depozitimit informal ose të paligjshëm të inerteve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është i mbështetur të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe në harmoni me VKM nr. 132, datë 6.3.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk përafron dispozita të *acquis communautaire* të Bashkimit European.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 575, datë 24.6.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte””, përmban 7 pika.

Në pikën 1 është bërë ndryshimi në fjalinë e dytë të pikës 4 ku zëvendësohet “vendimi me nr. 99, datë 18.2.2005, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar”” me fjalët “...të vendimit nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” sepse, ndërkohë, VKM 99/2005 është shfuqizuar

Në pikën 2, është shtuar pika 8/1 ku përcaktohet ripërdorimi i mbetjeve inerte dhe depozitimi i përkohshëm i tyre deri në ripërdorim, duke parashikuar edhe

procedurat dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nga subjektet zhvillues apo përfituesit e lejes së ndërtimit.

Në pikën 3, pas pikës 20, është shtuar pika 20/1 ku përcaktohet që krahas subjekteve private, roli i operatorit në kuptim të këtij vendimi ushtrohet edhe nga AKEM-i. Për venddepozitimet e përkohshme të administruara nga operatorë që janë subjekte private, AKEM ushtron mbikqyrjen dhe ndjekjen e funksionimit të venddepozitimit për qëllime të përputhshmërisë me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Rregullat e hollësishme të mbikqyrjes dhe ndjekjes së funksionimit të venddepozitimeve përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Në pikën 4, pas pikës 21, shtohen pikat 21/1, 21/2, 21/3, 21/4, 21/5 dhe 21/6, të cilat përcaktojnë se AKEM-i i kërkon njësisë së vetëqëverisjes vendore informacionin mbi vendet e përcaktuara prej saj për t'u përdorur si venddepozitime të përkohshme dhe specifikisht mbi ato që shtrihen në pasuri shtetërore.

Pika 21/1, përcakton detyrimin e AKEM-it për të kërkuar informacion zyrtar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) në rastet kur gjendja juridike e pronësisë mbi këto pasuri nuk është e qartë. Pas marrjes së informacionit, AKEM-i njofton NJVV-në për ato pasuri shtetërore që do të administrohen prej saj si venddepozitime të përkohshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pika 21/2, përcakton marrjen në administrim, mënyrat dhe procedurën e marrjes në dorëzim nga AKEM-i të pasurive të identifikuara sipas pikës 21/1 të këtij vendimi në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përkatësisht me ligjin nr. 8743/2001 “Për pronat publike dhe private të shtetit” dhe ligjin nr. 8744/2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

Në pikën 21/3 parashikohet që venddepozitimet e përkohshme miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

Pika 21/4 saktëson se në rastet kur venddepozitimet shtrihen në pasuri private, AKEM-i, pasi merr informacion nga NJVV-të, kërkon pranë KKTU-së miratimin e lejeve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Pika 21/5 përcakton detyrimin e operatorëve privatë që, para marrjes së lejes së ndërtimit për venddepozitim të përkohshëm nga KKTU, të depozitojnë një

garanci financiare/bankare për të mbuluar kostot e ndërtimit, të operimit, të mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm të lëndfillit edhe pas mbylljes së tij. Është parashikuar që masa e garancisë të përcaktohet me vendim të këshillave bashkiakë dhe do të jetë jo më pak se 10% e vlerës së strukturës së objektit. Kjo vlerë është në përputhje me masën e garancisë financiare/bankare që aplikohet për projektet e investimeve publike.

Pika 21/6 përcakton se për lejet e lëshuara nga autoritetet e zhvillimit të territorit subjekti zhvillues apo përfituesi i lejes së ndërtimit ka detyrimin të njoftojë përkatësisht sekretariatin teknik të KKTU për lejet në kompetencë të tij, autoritetin vendor dhe në të gjitha rastet AKEM-in, nëse pas marrjes së lejes së ndërtimit, mbetjet inerte do të ruhen në një venddepozitim tjetër të përkohshëm të ndryshëm nga ai i përcaktuar gjatë procedurave të lejes së ndërtimit, sipas përcaktimeve të pikës 8 të këtij vendimi.

Në pikat 5 dhe 6 e këtij projektvendimi është bërë zëvendësimi i togfjalëshit “ministria që mbulon infrastrukturën publike”, me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për mbetjet” dhe në pikën 21, hiqet togfjalëshi “në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën publike”.

Pika 7 përcaton organet përgjegjëse për zbatimin e vendimit, si Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, Sekretariatin Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi vjen si bashkëpropozim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, bazuar në problematikën e ngritur në shkresën nr. 4040 prot, datë 26.05.2025 të Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, e cila përcjell shqetësimin e Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë me situatën e mbetjeve inerte dhe kërkesën për mbështetje për gjetjen e zgjidhjeve për këto lloj mbetjesh.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 575, datë 24.6.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte””.

Mbi këtë bazë dhe pas vlerësimit të problematikës së adresuar lidhur me venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kanë hartuar këtë projektvendim.

Projektvendimi do të përcillet për mendim tek Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Zhvillimin e Territorit dhe tek Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij Vendimi nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI,
MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Belinda BALLUKU

**MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT**

Mirela KUMBARO FURXHI